



Xhozi dinte një mënyrë se si mund ta ndiqte shembullin e Jezu Krishtit.

Nga Xholin Brauni
(Bazuar në një ngjarje të vërtetë)

Kjo ngjarje ndodhi në SHBA.

Xhozi u ul me kushërirën e saj, Eshlinin, poshtë një peme jashtë shtëpisë së vet.

“Sikur të bënim diçka argëtuese për të fituar para”, – tha Xhozi.

“Ndoshta mund të fitojmë para duke bërë gjëra për njerëzit”, – tha Eshlini.

“Po sikur ta kthenim në një klub?” – u hodh përpjetë Xhozi me entuziazëm. “Si një klub përkujdesjeje për kafshët ose një klub për shëtitjen e qenve.”

“Mund të bëjmë lloj-lloj gjërash”, – tha Eshlini. “Njerëzit gjithmonë kanë nevojë për ndihmë. Dhe ata do të na paguajnë.”

Eshlini kishte të drejtë. Çdo ditë Xhozi shihte njerëz që kishin nevojë për ndihmë.

Papritur, Xhozit i erdhi një tjetër ide. Ajo ndjeu ngrohtësi brenda vetes. Ndjesia i kujtoi pagëzimin e vet vitin e kaluar. Ajo kishte premtuar se do ta kujtonte gjithmonë Jezusin dhe do ta ndiqte shembullin e Tij. Ajo e dinte një mënyrë se si mund ta bënte atë.

“Po sikur të krijonim një klub që i ndihmon njerëzit falas?” – pyeti Xhozi. Ndjenja e ngrohtë u bë më e fortë.

Eshlini i hapi sytë fort. “Do të ishte shumë qejf”, – tha ajo. “Ne mund të ndihmojmë njerëz në shkollë dhe në kishë, pak a shumë kudo.”

“Ne mund ta quajmë atë ‘Klubi i Përmirësimit të Gjërave!’” – i tha Xhozi. “Le t’ia fillojmë nesër në shkollë.”

Të nesërmen në pushim, Eshlini dhe Xhozi vrapuan deri në skajin e këndit të lojërave.

“A sheh ndonjë që mund ta ndihmojmë?” Eshlini u ngrit në majë të gishtave dhe pa drejt rrëshqitëses me gunga me ngjyrat e ylberit.

“Ende jo.” Xhozi kërkoi të shtyllat kacavjerrëse dhe të dyshja e kolovajzës. Fëmijët po rrëshqitnin dhe po lëkundeshin në kolovajzë. Ata po hidhnin topa dhe po luanin me litarë. Askush nuk dukej sikur kishte nevojë për ndihmë. Gjithkush dukej se e kishte një shok ose



ILLUSTRIMET NGA TANIA REX



shoqe. Më pas, ajo pa një vajzë më të vogël që ishte krejt e vetmuar, me një litar.

Xhozi e kapi Eshlinin për krahu. “Vështro atje tej!”

Xhozi dhe Eshlini gjetën litarë dhe shkuan drejt vajzës.

“Tjeta. Unë jam Xhozi.”

“Dhe unë jam Eshlini. Si e ke emrin?”

Vajza dukej e habitur. “Unë jam Lezli.”

“A dëshiron të luash me ne?” Xhozi tundi litarin për t’u hedhur.

Lezli buzëqeshi. “Po!”

Eshlini dhe Xhozi i mësuat Lezlit disa mënyra të reja për t’u hedhur me litar. Kur ra zilja, ato u ndanë. Xhozi u ndje mirë brenda vetes. Ajo e dinte se ishte Fryma e Shenjtë.

Pas asaj, sa herë që Xhozi dhe Eshlini e shihnin Lezlin në korridor, e përsëhendetnin atë.

Xhozi dhe Eshlini kërkuan njerëz të tjerë për t’i ndihmuar. Ndonjëherë ato u thoshin gjëra të këndshme njerëzve dhe përpiqeshin t’u jepnin zemër. Herë të tjera, ato ftonin fëmijë të luanin me to.

Një ditë, Xhozi i buzëqeshi një djali jashtë shkollës. “Më pëlqen bluza jote me dinosaur”, – tha ajo.

Djali vuri buzën në gaz dhe uli vështrimin për te bluza e tij. “Faleminderit.”

Ndërsa Xhozi u ul, ajo e kuptoi që nuk i kishte shkuar aspak në mendje ta bënte këtë për shkak të klubit! Ajo thjesht e bëri atë natyrshëm.

Xhozi mendoi për të gjithë shokët e shoqet që kishte zënë qëkurse ajo dhe Eshlini e filluan klubin e tyre. Xhozit i pëlqente vërtet t’i ndihmonte njerëzit. Kjo e bëri atë të kishte dëshirë të bënte më shumë gjëra të këndshme për të tjerët. “Klubi i Përmirësimit të Gjërave” po e bënte atë më të mirë. Dhe kjo e bënte të ndihej shkëlqyeshëm. ●